



**Kanton Zürich**  
**Sicherheitsdirektion**  
**Migrationsamt**

# Sans-Papiers-at



**Sans-Papiers-at** janë persona, të cilët qëndrojnë në Zvicër pa leje qëndrimi për më shumë se një muaj dhe për një kohë të paparashikueshme.

**Sans-Papiers-ave** mund t'u jepet një leje qëndrimi, nëse ka një rast të rëndë personal me peshë.

Një leje në rast të rëndë paraqet rregull përjashtues dhe i nënshtrohet shqyrtimit të rastit të veçantë.

Në këtë broshurë ju i gjeni kushtet që duhet të jenë plotësuar.



# Kushtet për dhënien e një leje për rastin e rëndë:



Zbulimi i identitetit me një dokument identifikimi nga vendlindja (pasaportë)



Kohëzgjatja shumëvjeçare e pranisë në Zvicër (të paktën 10 vjet qëndrim i pandërprerë për individë, të paktën 5 vjet për familje). Kohëzgjatja e pranisë mund të vërtetohet nëpërmjet kontratave të qirasë, kontratave të punës, llogaritjeve të arkave të sigurimit shëndetësor ose dokumenteve të ngjashme.



Asnjë kriminalitet (përjashtim: shkelje kundër Ligjit për të huajt dhe për integrim lidhur me qëndrimin ilegal).



Kushte të qëndrueshme financiare (punësim i përhershëm me të ardhura të mjaftueshme për pavarësinë ekonomike).



Asnjë ekzekutim i detyrueshëm ose certifikata të hapura për borxhe.



Dëshmi e njohur mbi gjuhën me certifikatë mbi nivelin e gjermanishtes A2.



Integrim i mirë në Zvicër (rrjet i lidhjeve, pjesëmarrje në jetën sociale p.sh. takime në lagje ose në shoqata).



Papranueshmëri e riintegrit në shtetin e origjinës.

# Formim profesional bazë për Sans-Papiers-at e rinj.

Për mundësimin e një formimi profesional bazë Sans-Papiers-ave të rinj mund t'u jepet një leje qëndrimi në kushtet si vijojnë:



Zbulimi i identitetit me një dokument identifikimi nga vendlindja (pasaportë).



5 vjet ndjekje e pandërprerë e shkollës së detyrueshme në Zvicër. Pjesëmarrjet në ofertat urëlidhëse llogariten.



Paraqitja e një kërkesë brenda dymbëdhjetë muajve pas mbarimit të shkollës së detyrueshme ose të ofertës urëlidhëse.



Kërkesë e një punëdhënësi me kontratë pune, në të cilën respektohen kushtet e punës sipas nenit 22 AIG (Ligji për të huajt dhe për integrimin).



Asnjë shkelje kundër rendit juridik (përrjashtim: shkelje kundër Ligjit për të huajt dhe për integrim lidhur me qëndrimin ilegal).



Asnjë ekzekutim i detyrueshëm ose certifikata të hapura për borxhe.

# Procedura

Sans-Papiers-at mund ta paraqesin kërkesën për rastin e rëndë tek Zyra e Migrimit e kantonit të Cyrihut. Me kërkesën duhet të dëshmojnë identiteti dhe kriteret e shënuara në fq. 3.

Zyra e Migrimit ia paraqet vendimet e saj mbi kërkesat për rastet e rënda Komisionit të rasteve të rënda për të mbajtur qëndrim, nëse parashtruesit e kërkesave asnjëherë nuk kanë kaluar një procedurë sipas së drejtës së azilit ose të të huajve (§ 1 i Urdhërësës mbi komisionin e rasteve të rënda). Nëse një rekomandim i Komisionit shmanget nga vlerësimi i Zyrës së Migrimit, vendos kryetarja ose kryetari i drejtorisë së sigurisë.

Një vendim pozitiv duhet t'i paraqitet për miratim Sekretariatit të Shtetit për Migrim (SEM). Nëse SEM e pranon dhënien e lejes së qëndrimit, kjo mund të lëshohet. Një vendim negativ mund të kontestohet me mjete të rregullta të ankimit.



## Informacione të mëtejshme për të drejtën e të huajve

Informacione të detajuara për të drejtën e të huajve gjeni në udhëzimet e Zyrës së Migrimit të kantonit të Cyrihut nën [www.zh.ch/ma](http://www.zh.ch/ma)



**Kanton Zürich**  
**Sicherheitsdirektion**  
**Migrationsamt**

Berninastrasse 45  
8090 Zürich  
Telefon +41 43 259 88 00  
[www.zh.ch/ma](http://www.zh.ch/ma)